



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 614 Prot.

Tiranë, më 26 / 05 / 2020

Lënda: Sugjerime dhe komente mbi disa ndryshime në Ligjin nr.9831, date 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politike të regjimit komunist, të ndryshuar" dhe projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politike të regjimit komunist, të ndryshuar".

Z. ULSI MANJA
KOMISIONI PËR ÇËSHTJET LIGJORE, ADMINISTRATËN PUBLIKE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Për dijeni:

Z. GRAMOZ RUCI
KRYETAR
KUVENDI I SHQIPËRISË

I nderuar Z. Manja,

Në vijim të kërkesës Tuaj, për të dhënë sugjerime në lidhje me projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politike të regjimit komunist, të ndryshuar", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u konsultua mbi këtë projekt-ligj dhe me Ligjin aktual nr.9831, datë 12.11.2007, jep propozimet si më poshtë:

Së pari, mbështesim iniciativën mbi ndryshimet ligjore të projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politike të regjimit komunist, të ndryshuar", të cilat synojnë dëmshpërblimin financiar të ish të dënuarve

politikë, nëpërmjet: zgjerimit të rrethit të përfituesve¹, dhënien e dëmshpërblimit efektiv dhe moszbritjen nga vlera e dëmshpërblimeve të përfitimeve në ligje të tjera. Në mënyrë të veçantë, mbështesim propozimet mbi ndryshimet në nenin 7, të cilat synojnë të japin dëmshpërblim për familjarët e të dënuarve me dënim kapital, në vlerën e 25 viteve burgim. Ky ndryshim ligjor, do të bëjë të mundur një dëmshpërblim efektiv, pra zhdëmtim në përpjestim me dëmin e shkaktuar.

Së dyti, Komisioneri nën frymën e Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, sugjeron të rishikohet neni 8 “*Rrethi i familjarëve*” i Ligjit nr.9831, datë 12.11.2007, “*Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politike të regjimit komunist, të ndryshuar*”. Në pikën 1, të nenit 8 “*Rrethi i familjarëve*”, parashikohen familjarët e viktimave që përfitojnë, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjor, dëmshpërblimet. Për trashëgiminë me ligj referimi duhet të bëhet vetëm në dispozitat e Kodit Civil dhe jo të krijohet një standart për familjarët përfitues, sipas Ligjit Nr. 9831, datë 12.11.2007, pasi kjo bie ndesh me dispozitat e Kodit Civil, konkretisht në nenet 360, 361, 362, 363, 364.

Pika 1, e nenit 8, e kufizon rrethin e familjarëve deri në shkallë të tretë, ndërkohë që Kodi Civil, në nenin 366 te tij, përcakton trashëgimtarët ligjor deri në shkallë të gjashtë². Ligji nr.10 111, datë 2.4.2009 nuk mund të jetë në kundërshtim as nuk mund të anashkalojë të drejtën e trashëgimtarëve ligjor. Kodi Civil ka një parashikim të posçëm mbi Institutin e “Trashëgimisë me ligj”.

Së treti, në pikën 3, të nenit 8, parashikohet se: “3. Në rastin kur e drejta e përfitimit të dëmshpërblimit financiar përfundon me mbylljen e rrethit të familjarëve që nuk jetojnë, të përcaktuar sipas pikës 1, të këtij neni, dëmshpërblimi financiar, për pjesën takuese të tyre, kalon në buxhetin e shtetit”. Kjo dispozitë, përveç faktit që bie ndesh me dispozitat e Kodit Civil, siç shpjeguar më lart, çënon dhe parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit të këtyre përfituesve “me statusin e trashëgimtarëve të viktimave”, duke mos përsirë, në mundësinë e trashëgimisë ligjore, rrethin e 4, 5, 6 të trashëgimtarëve³, siç ndodh në rastet e zakonshme të zbatimit të dispozitave të K.C mbi trashëgiminë ligjore.

Së katërti, rrethi i familjarëve përfiton dëmshpërblimin në cilësinë e trashëgimtarëve ligjor dhe ky institut, në parashikimet e Kodit Civil, ka treguar shumë kujdes “për kategorinë e të paftëve në punë”, duke i mbrojtur në mënyrë të posaçme. “Trashëgimtari i paaftë për punë⁴” i rrethit të

¹ Duke përputhur ligjin. 9831, date 12.11.2007 Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politike të regjimit komunist, të ndryshuar”, me ligjin Nr.7748, dt.29.07.1993, “Për statusin e ish te denuarve dhe perndjekurve politike”.

² Neni 366 K.C Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, thirret në trashëgim shteti.



³ Në rastet kur nuk ka trashëgimtarë të rretheve parardhëse.

⁴ Trashëgimtari i paaftë për punë Neni 371 “Trashëgimtarë të paaftë për punë janë ata që në kohën e vdekjes së trashëgimlënësit nuk kanë mbushur moshën 16 vjeç, ose 18 vjeç kur vazhdojnë mësimet, burrat që kanë mbushur

katërt, të pestë dhe të gjashtë, çënohet nga parashikimi i pikës së 3, të nenit 8, duke u përjashtuar.

Sugjerojmë, që neni 8 të zbatohet parashikimet e Kodit Civil, mbi rradhën e trashëgimtarëve ligjor, në mënyrë që mos të çënohen kategoria e të paaftëve në punë, për sa kohë që të drejtën për dëmshperblim, për këtë të drejtë jopasurore vetjake, “rrethi i familjarëve” në nenin 8, e përfiton me statusin e trashëgimtarit ligjor.

Duke besuar që mendimet Tona të merren në konsideratë, shprehim angazhimin institucional për bashkëpunime të mëtejshme.

KOMISIONERI

ROBERT GAJDA


moshën 60 vjeç dhe gratë që kanë mbushur moshën 55 vjeç si dhe, pavarësisht nga mosha, ata që janë invalidë të grupit të parë dhe të grupit të dytë.